

## Legjionaret/ Andi Lila i jep fitoren PAS Janines

nga AlbaniaSoccer

E hënë, 23 Dhjetor 2013 22:49

---



Andi Lila ka shenuar golin e fitores per skuadren e PAS Janines. Mbrojtesi shqiptar po kalon nje moment te arte tek skuadra greke dhe vec paraqitjeve mjaft te mira ai tani po gjen edhe rrugen e golit edhe pse luan shume larg portes. Lila ka shenuar golin e fitores ne rezultatin 2-1 qe skuadra e tij mori ne shtepi ndaj Arisit te Selanikut. Lila ne kete ndeshje luajti si qendermbrojtes ndersa Vila u aktivizua si mbrojtes i djathte. Skuadra e dy shqiptareve pas kesaj fitore renditet ne vendin e 7 ne klasifikim. Persa i perket Liles, ai kerkohet nga shume skuadra europiane dhe e ardhmja e tij sipas mundesive me te medha do te jete ne Serine A, ne Itali.